

# LIDHSHMËRIA E GJUHËS SHQIPE NDËRMJET PLAN-PROGRAMEVE PARAUNIVERSITARE DHE ATYRE UNIVERSITARE

Prof.asoc.dr. Shkelqim Millaku  
Universiteti 'Ukshin Hoti' Prizren, Fakulteti i Filologjisë  
[shkelqim.millaku@uni-prizren.com](mailto:shkelqim.millaku@uni-prizren.com)

## Abstract

*Mësimxënia dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe, si në nivelin parauniversitar, ashtu edhe në atë universitar ka lidhshmëri, por në nivel vendi e kombi ka edhe dallueshmëri, si në plan-programet 'kurrikulat' parauniversitare, ashtu edhe në 'programet' universitare, të cilët përmes tyre, po krijojnë hapësirë lehtësuese e sfiduese për ta mësuar, ligjëruar e zotëruar gjuhën shqipe.*

*Kumtesa ime do t'i trajtojë disa çështje.*

*Çështjen e parë që do ta analizojmë në këtë kumtesë janë disa plan-programe parauniversitare të gjuhës shqipe dhe në çështjen e dytë, duke ju referuar kurrikulave parauniversitare do t'i përshkruajmë, por edhe do ta zgjerojmë fokusin në programet universitare, të cilat përgatisin mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe; të gjuhës shqipe apo të letërsisë shqipe. Programe të tilla, a janë apo nuk në përputhshmëri për të nxjerrë mësimdhënës të kualifikuar për gjuhën dhe letërsinë shqipe?*

*Çështjet në fjalë duhet të kenë lidhshmëri të ngushtë ndërmjet tyre, mirëpo ka raste që duhet të kërkohet harmonizim, unifikim dhe standardizim të detyruar, në mënyrë që gjuha shqipe të mësohet, studiohet e ligjërohet në nivel vendi e kombi me programe kombëtare të kodifikuara e të standardizuara.*

**Fjalët kryesore:** *Gjuha shqipe, plan – programet (kurrikulat), programet universitare, lidhshmëria.*

## Hyrje

Mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe në tekstet e reja që janë në përdorim, bazën e ndërtimit apo të krijimit të tyre, si tekste parauniversitare e kanë në fushën e “kurrikulave<sup>1</sup>”, në këtë rast për studim e kemi fushën e gjuhës (gramatikën) dhe të komunikimit. Kumbësia ime do të fokusohet në rolin, lidhshmërinë dhe përmbajtjen e sistemit (gjuhësor) gramatikore në disa klasë të programeve “kurrikulave” të miratuar nga MASHT-i (MASHTI). Lidhshmëria gramatikore në disa programe të gjuhës shqipe dhe të letërsisë kanë lënë hapësirë të dëshirueshme për t’i rianalizuar dhe për t’i risistemuar drejt sipas kodifikimit të shqipes standarde dhe rregullave gramatikore të saj.

Plan-programet e gjuhës shqipe në përgjithësi janë në nivelin e pranueshëm, mirëpo ka raste që kanë edhe lëshime të mundshme përmbajtjesore dhe profesionale e shkencore, prandaj si të tilla lëshime krijojnë sfida edhe në hartimin e teksteve mësimore.

Në nivel kombi, kurrikulat dhe programet universitare për gjuhën shqipe kërkohet që sa më parë të unifikohen dhe të krijojmë tekste të pranueshme, unike e cilësore.

### 1. Qëllimi i studimit

Kurrikultat parauniversitare të gjuhës shqipe dhe programet universitare ekzistuese janë të detyruara për t’u modifikuar dhe për t’i standardizuar e unifikuar për gjithë shqiptarët kudo që janë, sepse përveç zbrazëtirave profesionale e shkencore që i kanë, ato duhet edhe të modifikohen edhe për faktin e ndikimit të inteligjencës artificiale. Një studim analizues i tillë është i domosdoshëm, si për t’i analizuar kurrikulat e gjuhës shqipe, por edhe për t’i propozuar plotësimet e mundshme, mirëpo edhe për t’i rishikuar e standardizuar tekstet parauniversitare. Studimi ka për qëllim një analizë konkrete për disa kurrikula parauniversitare, mirëpo edhe përshkrimin e disa programeve universitare, qofshin ato të studimeve themelore, apo edhe të

---

<sup>1</sup> Fjala kurrikulë nuk është fjalë shqipe dhe si e tillë në rast ridiskutimi, mendoj si fjalë e tillë duhet të shikohet mundësia për ta zëvendësuar me fjalën shqipe, ose për ta përdorur e rikthyer kompozitën këpujore plan-program.

masterit, të cilët programe përgatisin mësimdhënës “të kualifikuar” për mësimdhënien e gjuhës shqipe. Qëllimi thelbësor është që të propozohet, që gjuha shqipe të mësohet e studiohet me përmbajtje, kurrikula, tekste dhe programe të njëjta në gjithë kombin tonë, madje edhe të mendohet, por edhe të punohet edhe ma seriozisht për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe në diasporë. Këtu meriton të shtohet kujdesi edhe për standardizimin e kurrikulave dhe të teksteve të gjuhës shqipe për minoritetet, të cilët jetojnë në Kosovë, Shqipëri dh në Maqedoni, por që e kanë të obliguar apo plotësuese mësimin e gjuhës shqipe.

Kërkohej një koncentrim kombëtar i obliguar edhe për diasporën, të cilët tani i kanë plan-programet dhe tekste, mirëpo edhe për këtë shoqëri shtetet amë janë të obliguara ta shtojnë organizimin dhe kujdesin për ta ruajtur e zhvilluar gjuhën gjithandej.

## **2. Metodologjia e studimit**

Kurrikulat parauniversitare dhe programet universitare për gjuhën shqipe janë shtyllat kryesore që i krijojnë dhe i ndërtojnë breza e rinj, e në këtë rast e ruajnë dhe e zhvillojnë gjuhën shqipe, ose në të kundërtën edhe e shtrembërojnë, atë. Pas grumbullimit të literaturës bazike dhe pasi i kemi analizuar e studiuar si kurrikulat parauniversitare, ashtu edhe programet universitare, por edhe duke qenë hartues i kurrikulës (pjesës së gramatikës), pastaj edhe hartues i programeve universitare, në këtë rast si analizues, vlerësues, kritikues e vetëkritikues, mendoj përmes këtij punimi do t’i paraqesim disa çështje me interes për standardizimin dhe rikodifikimin e kurrikulave dhe të programeve të gjuhës shqipe, të cilat, në nivel kombi kërkohen për t’u unifikuar e standardizuar.

## **3. Gjuha shqipe dhe kurrikulat parauniversitare**

Në këtë studim do t’i analizojmë disa plan-programe apo ‘kurrikula’, si: Kurrikula lëndore (programi mësimor): *Gjuhë shqipe (klasa e parë)*; *Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim - Kurrikulat lëndore (programet*

mësimore). *Gjuhë shqipe (klasa e tretë); Gjuhë dhe komunikim (klasa e gjashtë); Gjuhë shqipe dhe letërsi - Gjimnazi i shkencave shoqërore – gjuhësore (klasa e dhjetë).*

**a. Kurrikula lëndore për klasën e parë** është hartuar për “*shtatë fusha, përkatësisht për lëndët mësimore, si: Gjuhë dhe komunikim, artet, matematikën, shkencat e natyrës, shoqërinë dhe mjedisin, jeta dhe puna, dhe edukatë fizike, sportet dhe shëndeti (Kurrikula lëndore, klasa e parë).* Në plan-programin, apo në kurrikulën mësimore për klasën e parë janë paraparë disa çështje e koncepte të ndryshme, tema dhe rezultatet e të nxënit të lëndës, të cilat e brumëzojnë kurrikulën, por janë edhe themelet e parë për të krijuar e ndërtuar brezat e ardhshëm.

Gjuha shqipe për nivelin në fjalë ka të planifikuara disa koncepte, si për tekstet letrare, ashtu edhe për ato jo letrare, për gjuhën figurative dhe jo figurative, për kritikën, teorinë, historinë dhe sistemin gramatikor. Theksi i veçantë i këtij studimi është për sistemin gramatikor. Temat që janë të parapara në sistemin gjuhësor për klasën e parë janë, si në tabelën e paraqitur, citoj:

<i>“Konceptet</i>	<i>Temat</i>	<i>Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)</i>
<i>Sistemi gjuhësor</i>	<i>Tingujt</i> <i>Shkronjat</i> <i>Rrokjet</i> <i>Fjala</i> <i>Fjalja</i> <i>Shenjat e pikësimit</i> <i>Intonacioni</i> <i>Foljet ndihmëse</i>	<i>Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanorë dhe bashkëtingëllorë;</i> <i>Dallon rrokjen në fjalë;</i> <i>Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</i> <i>Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;</i> <i>Përdorë drejt shenjat e pikësimit: pikën, presjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen etj.;</i> <i>Shkruan drejt fjalët, fjalitë dhe i shqipton me intonacionin e duhur;</i> <i>Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam</i>

	<p><i>Emri, mbiemri, përemri.</i></p>	<p><i>në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme;</i></p> <p><i>Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin;</i></p> <p><i>Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;</i></p> <p><i>Shkruan fjalë duke parë figura;</i></p> <p><i>Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;</i></p> <p><i>Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdorë ato për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime;</i></p> <p><i>Bën vizatime të thjeshta mbi bazë imagjinare dhe shkruan fjali për përmbajtjen e figurës që ka vizatuar;</i></p> <p><i>Përdorë lojën për të mësuar;</i></p> <p><i>Lexon tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse (kurrikula lëndore, klasa e parë)”. </i></p>
--	---------------------------------------	--

*Tabela 1*

Në tabelën e parë, radhitja e temave nuk janë të sistemuar drejt dhe lidhshmëria e tyre gramatikore nuk e kanë lidhshmërinë dhe përputhjen kronologjik, të cilat në një gjendje të tillë mund të krijojnë hapësirë për t'i risistemuar, por edhe për të lehtësuar krijimin e teksteve të reja, prandaj pas plotësimit të tyre edhe lexueshmëria dhe kuptueshmëria mund të jetë më e lehtë.

Në pjesën e temave ku janë të radhitura tingujt dhe deri të përemrat kanë hapësirë për risistemim dhe rikorrigjim apo rirregullim. Radhitja e temave do të duhej të ishte nga tingujt apo shkronjat, pastaj rrokja dhe fjala. Kështu

do të duhej të jetë një lidhje apo shtrirje gramatikore, pastaj të fillohet me sistemin emëror dhe të përshkruhen apo kërkohen shtyllat thelbësore, por edhe të dallohen nga sistemi foljor. Pas analizës morfologjike krijohet mundësia për përshkrimin e funksionit të fjalëve në fjali, pra për mundësitë e analizave sintaksore. Për këtë nivel, kjo e fundit është e ngarkuar.

Në vazhdim i paraqesim disa lëshime që i kemi në tabelën e parë, por edhe në pjesën ku edhe i presim rezultatet, apo mbi këto lëshime mund të jenë krijuar edhe tekstet e gjuhës shqipe.

Në kurrikulë, kur është fjala për foljet ndihmëse, citoj: “Kupton dhe dallon foljet ndihmëse *kam dhe jam* në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme (Kurrikula lëndore, klasa e parë).”

Mbështetur në këtë citim mund të themi se koha e ardhme i përket mënyrës dëftore dhe mbi këtë baza të kësaj kohe jemi të mendimit se është menduar dhe është përcaktuar për ta mësuar mënyrën dëftore. Në këtë citat ka dy shqetësime si për kohën e shkuar të mënyrës dëftore, po ashtu edhe për kohën e ardhme të kësaj mënyre.

- a. Shqetësimi i parë, përcaktimi për ta mësuar kohën e kryer që është kohë e përbërë dhe që ndërtohet më anë të foljes ndihmëse *kam* apo *jam* dhe pjesoren e foljes (p.sh. *kam lexuar, jam lexuar*), pa e mësuar të pakryerën dhe pa e mësuar pjesoren e foljes, konsideroj se është bërë veprim i ngutshëm. Prandaj, përzgjedhja e mënyrës dëftore është e drejtë, por përzgjedhja e kohës së kryer është e ngutshme. Planifikimi do të duhej të kishte filluar nga: E pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe e fundit e kryer e tejkshuar.
- b. Shqetësimi i dytë është për kohën e ardhme. Këtu nuk është e përcaktuar se për cilën nën kohë të së ardhme bëhet fjalë, apo për të gjitha, madje edhe për variante dialektore të tyre, të cilat e përshkruajnë se një veprim do të kryhet në të ardhmen.

Mësimi dhe planifikimi i sistemit foljor do të duhej të mendohej edhe për lidhshmërinë kronologjike të mënyrave të tjera, por edhe për pjesë të tjera të ligjëratave.

Planifikimi i temave (emrave, mbiemrave, përemrave) dhe rezultateve që

janë të planifikuara në tabelën e parë të sistemit emëror kanë disa lëshime. Citoj: “*Kupton, dallon dhe përdorë drejt emrin, mbiemrin dhe përemrin (Kurrikula lëndore, klasa e parë).*”

Tri pjesët e ligjëratës në fjalë janë të përshkruara në përgjithësi për t’i mësuar dhe planifikuar, por mendoj do të ishte mirë të përshkruhet një tip i sistemuar në formën e shkallëshmërisë, si p.sh. duke filluar nga emrat (e përveçëm), si: Agroni, Arta, Lulja, Biblioteka Kombëtare, Shkolla e Informatikës, Luli, Migjeni..., pastaj emrat e përgjithshëm (abstraktë, konkret, përmbledhës, të lëndës), të cilët janë bukur të zgjeruar.

Mendoj do të ishte e mjaftueshme për të planifikuar se do të mësohen vetëm emrat e përveçëm, kurse për emrat e përgjithshëm në një nivel tjetër. Në këtë pjesë të planifikimit nuk është e përcaktuar çka duhet të mësohet për mbiemrin dhe për cilin përemër. Këtu është harruar të përmendet e të mësohet sipërfaqësisht edhe për numërorin.

Në vazhdim është e rëndësishme të përmendet se fjalia mësohet para së të ligjërohen pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratave, prandaj kuptueshmëria e tyre është e vështirë dhe hartuesi i teksteve do të këtë vështirësi për t’i krijuar tipet e fjalive të thjeshta dhe të përbëra, qoftë sipas modalitetit apo kumtimit të tyre, prandaj mësimi mekanik i tyre nuk është në domenin e moshës së re.

Kur thuhet fjalia<sup>2</sup>, këtu kemi të bëjmë me fjalitë e thjeshta dhe të përbëra dhe me nënlojet e tyre.

Mendoj mund të propozohet për t’u mësuar fjalia, por më vonë, pra pas zotimit thelbësor të emrit dhe të foljes mund të ishte propozuar për t’u mësuar fjalia e thjeshtë dhe llojet e saj.

---

<sup>2</sup> Këtu mund të flitet për fjalinë sipas modalitetit, kumtimit apo qëllimit të thënies dhe për fjalinë e thjeshtë apo të përbërë. Për fjalinë ju referohemi FGjSh, si: Njësi tërësore e ligjëritimit, e cila përbëhet nga një varg fjalësh (ose edhe nga një fjalë e vetme), të formësuar e të lidhura gramatikisht sipas ligjeve të një gjuhe të caktuar dhe është mjete kryesor për formimin, shprehjen e kumtimit e mendimit. Fjali e thjeshtë (e zgjeruar). Fjali drejtuese fjali prej së cilës varet një fjali tjetër. Fjali kryesore (e varur). Fjali e bashkërenditur (e nënrenditur). Fjali dëftore (kushtore, pyetëse). Gjymtyrët e fjalisë.

Mbështetur në atë që është thënë më lart, si në përshkrimin e programit, po ashtu edhe në rekomandimet e propozuara mund të themi se programi mësimor për klasën e parë dhe kryesisht pjesa e sistemit gramatikor kanë hapësirë për t’i sistemuar më mirë rregullat gramatikore, por ky program duhet të jetë i unifikuar dhe i standardizuar për gjitha trojet shqiptare.

**b. Fusha e kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim - Kurrikulat lëndore, programet mësimore. Gjuhë shqipe (klasa e tretë).**

Plan-programi i dytë që do të analizohet është dhënë në tabelën vijuese, e cila po prezantohet në këtë pjesë të punimit, por edhe kjo i ka disa shkëputje përmbajtjesore të temave, ashtu si në analizën e tabelës së parë, të cilat shkëputje meritojnë të rregullohen dhe të risistemohen drejt. Disa nga ato janë: Mësim i hershëm i funksionit të fjalëve në fjali; trajtat e emrave; kohet e foljeve dhe sipas kumtimit nuk ka tip të fjalisë **habitore**, që këtu është e përshkruar gabimisht.

“Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
<i>Sistemi gjuhësor</i>	<i>Emra të përveçëm dhe të përgjithshëm</i> <i>Trajta e emrave;</i> <i>Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm;</i> <i>Përemrat vetorë;</i> <i>Numëror-</i> <i>Foljet në kohën e tashme, të ardhme, të kryer dhe të pakryer të mënyrës dëftore;</i> <i>Ndajfolja e kohës, e vendit dhe e mënyrës;</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Identifikon kategoritë gramatikore të fjalëve (gjinia, numri);</i></li> <li>• <i>Dallon emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm;</i></li> <li>• <i>Dallon emrat në trajtën e shquar dhe të pashquar;</i></li> <li>• <i>Identifikon mbiemrin;</i></li> <li>• <i>Dallon mbiemrat e nyjshëm nga ata të panyjshëm;</i></li> <li>• <i>Identifikon dhe përdor drejt përemrat vetorë;</i></li> <li>• <i>Dallon numërorët themelorë nga ata rreshtorë;</i></li> </ul>

	<p><i>Parafjalët: me, nga, prej, më, në.</i></p> <p><b><i>Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e zgjeruar; gjymtyrët kryesore dhe të dyta;</i></b></p> <p><b><i>Lidhja dhe përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën</i></b></p> <p><i>Llojet e fjalive: dëftore, pyetëse dhe <b>habitore;</b></i></p> <p><i>Drejtshkrimi.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Identifikon foljet dhe zgjedhon ato në kohët kryesore të dëftores;</i></li> <li>• <i>Identifikon ndajfoljet dhe pyetjet me të cilat gjenden ato;</i></li> <li>• <i>Dallon disa nga parafjalët më të përdorshme;</i></li> <li>• <i>Identifikon pjesët kryesore të fjalisë;</i></li> <li>• <i>Shpreh marrëdhëniet e kryefjalës me kallëzuesin;</i></li> <li>• <i>Identifikon dhe përdor fjali të llojeve të ndryshme: dëftore, pyetëse, habitore;</i></li> <li>• <i>Përdor drejt emrat e përveçëm, mbiemrat, foljet numërorët dhe parafjalët;</i></li> <li>• <i>Rishikon dhe vlerëson qartësinë e shkrimit për të përmirësuar përmbajtjen;</i></li> <li>• <i>Dallon bashkëtingëlloret në të shqiptuar;</i></li> <li>• <i>Zbaton veprime brenda fjalisë (heq, shton ose zhvendos fjalë në fjali pa e prishur kuptimin e saj);</i></li> <li>• <i>Përshkruan objekte mbi bazën e modeleve;</i></li> <li>• <i>Shkruan tekst të shkurtër sipas modeleve dhe figurave të dhëna;</i></li> <li>• <i>Zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit;</i></li> </ul>
--	---	---

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Përdor drejt shenjat e pikësimit, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit dhe shkronjën e madhe;</i></li> <li>• <i>Dallon llojet e fjalive sipas shenjave të pikësimit</i></li> <li>• <i>Shkruan drejt e qartë dhe përdor shenjat e pikësimit (Kurrikula lëndore, klasa e tretë).</i></li> </ul>
--	--	--

*Tabela 2*

Mbështetur në temat që janë të prezantuar në tabelle e dytë, por edhe në rezultatin e të nxënies dhe duke filluar nga tema e parë “*Emra të përveçëm dhe të përgjithshëm*” ka hapësirë profesionale për t’i menduar, por edhe do të duhej të renditen apo specifikohen më mirë. Planifikimi për t’i përfshirë gjithë emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm është e pamundur për nivelin dhe përmbajtjen e lëndës. Këtu mirë do të ishte të rekomandohet për emrat e përgjithshëm (emrat konkret dhe abstrakt), kurse për emrat e përveçëm të propozohet për emrat e institucioneve, të vendeve etj.

Propozimi për të mësuar “*trajtën e emrave*”, e cila nuk është e përshkruar, se për cilën trajtë bëhet fjalë, për atë të shquar apo të pashquar, njëjës apo shumës. Mendoj edhe këtu duhet të planifikohet e specifikohet me precizitet.

Një rekomandim të ngjashëm e kemi edhe për mbiemrin dhe përemrin, kurse mungon vazhdimi i planifikimit për të mësuar për numërorin.

Planifikimi për ta mësuar sistemin foljor ka lëshime në lidhshmërinë kronologjike. Kategoritë gramatikore që i ka folja dhe lidhshmëria e tyre nuk është e sistemuar sipas kodifikimit gjuhësor. Këtu mund t’i veçojmë disa:

- Në këtë nivel duhet të propozohet për të mësuar edhe për mënyrat e tjera të foljeve dhe jo vetëm për mënyrën dëftoren. Të propozohet për t’u mësuar edhe mënyra lidhore apo habitore.
- Të planifikohet ligjërimi dhe zotimi i tri zgjedhimeve të foljeve (lexoj, hap, zë).

- Në këtë pjesë të planifikimit, pra të sistemit foljor nuk është menduar për t'i prezantuar dhe mësuar gjitha pjesët e ndryshme dhe të pandryshueshme të ligjëratave.

Propozimi për t'i mësuar fjalitë e thjeshta dhe të zgjeruara, mendoj edhe këtu ka qenë e mundur që të rekomandohet për t'i mësuar fjalitë sipas qëllimit të thënies, fjalitë sipas modalitetit, apo ndërtimit gramatikor.

Rekomandimi për të mësuar për kryefjalën dhe kallëzuesin për në klasën e tretë mendoj është pak e ngutshme, por edhe këtu do të duhej të rekomandohet nga baza, pra për kallëzuesin e thjeshtë apo edhe për kryefjalën e shprehur më emra të përveçëm, mirëpo edhe kjo është një ngarkesë psiko-fizike e tepruar.

Në këtë nivel, apo në klasën e tretë është planifikuar për t'u mësuar një tip i fjalisë që quhet "**fjalja habitore**". Nuk e kuptoj se për çfarë lloji tipi të fjalive bëhet fjalë. Në gramatikën e gjuhës shqipe ka folje të mënyrës habitore, pra kur është fjala për foljen ka mundësi të kemi mënyrën habitore, kurse për fjalinë në gjuhën shqipe sipas kumtimit kemi fjali dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore etj.

Për të përfunduar mendimin dhe rekomandimin tim për këtë plan-program mund të themi se duhet të rishikohen dhe të risistemohen temat, por edhe të përshtatën të gjitha rregullat gramatikore për moshën e klasës së tretë. Mbi bazën e atyre rregullave do të duhej të krijohen edhe tekste e gjuhës shqipe. Kjo çështje duhet të rregullohet e të harmonizohet për gjitha trojet shqiptare, madje duke e përfshirë edhe diasporën.

**c. Fusha e kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim - Kurrikulat lëndore, programet mësimore. Gjuhë shqipe (klasa e gjashtë). Tabela e tretë, ashtu sikur ajo e para dhe e dyta që kanë shkëputje të temave, edhe kjo tabelë ka hapësirë për t'u modifikuar, citoj:

<i>"Konceptet</i>	<i>Temat</i>	<i>Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)</i>
<i>Sistemi gjuhësor</i>	<i>"Gjuha standarde dhe dialektore</i>	<i>Dallon format e gjuhës standarde nga ato dialektore;</i>

	<i>Fonetikë, fonologji</i>	<i>Dallon, tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin;</i>
	<i>Leksikologji</i>	<i>Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret sipas shqiptimit;</i> <i>Përcakton theksin e fjalës në fjali.</i>
	<i>Sintaksë</i>	<i>Pasuron fjalorin dhe njuh kuptimin e fjalës;</i>
	<i>Rrethanori</i>	<i>Dallon dhe përdor fjalë me kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm;</i>
	<i>Morfologji:</i>	
	<i>Emri, kategoritë e tij gramatikore</i>	<i>Dallon dhe përdor fjalët me shumë kuptime;</i>
	<i>Mbiemri dhe kategoritë e tij</i>	<i>Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë;</i>
	<i>Përemrat</i>	<i>Dallon rrethanorin e vendit, të kohës, të shkakut si dhe përcaktorin e ndajshimit;</i> <i>Dallon emrin dhe kategoritë e tij; (gjininë, numrin, rasat, lakimi);</i>
	<i>Numërorët</i>	<i>Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm;</i>
	<i>Folja, kuptimet gramatikore të saj</i>	<i>Dallon dhe i përdorë drejt parafjalët sipas rasave;</i> <i>Dallon mbiemrin dhe kategoritë gramatikore tij.(gjininë, numrin, rasat, lakimin, shkallët ).</i>
	<i>Ndajfoljet dhe llojet e saj</i>	<i>Dallon dhe përdor drejt përemrat; vetorë, vetvetor, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë dhe të pacaktuar.</i>
	<i>Parafjala</i>	
	<i>Lidhëzat</i>	<i>Dallon numërorët themelor dhe numërorët rrjeshtor.</i>
	<i>Fjalëformim</i>	

	<p><i>Drejtshkrim</i></p>	<p><i>Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës;</i></p> <p><i>Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj;</i></p> <p><i>Dallon zgjedhimin e foljes ,</i></p> <p><i>Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprare dhe joveprare të saj;</i></p> <p><i>Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore;</i></p> <p><i>Dallon llojet e ndajfoljes, si ndajfolje mënyre, sasië , kohe,vendi dhe i përdorë ato drejtë në të folur e të shkruar .</i></p> <p><i>I përdorë drejtë parafjalët: me, për, në, nga te, gjer, prej,ndaj, pranë, larg dhe dallon nga ndajfoljet .</i></p> <p><i>Dallon lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.</i></p> <p><i>Dallon Fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë;</i></p> <p><i>Dallon llojet kryesore të fjalive (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore) format e tyre (pohore, mohore);</i></p> <p><i>Dallon fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura;</i></p> <p><i>Dallon përbërësit e fjalës: rrënjën, temën, parashtesat prapashtesat, mbaresat;</i></p> <p><i>Dallon fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura;</i></p>
--	---------------------------	---

		<p><i>Në të shkruar përdorë drejt shenjat e pikësimit, pikën, presjen dhe pikëçuditjen;</i></p> <p><i>Përdorë drejt shkronjën e madhe dhe të vogël;</i></p> <p><i>Shkruan drejt apostrofin në fjalë (Kurrikula lëndore, klasa e gjashtë)''.</i></p>
--	--	---

*Tabela 3*

Në këtë plan-program janë paraparë temat e integruara, por edhe këtu sikur edhe në plan-programin e klasës së tretë, lidhshmëria e tyre duhet të bëhet në një mënyrë tjetër, ashtu si janë rregullat gramatikore. Në vazhdim i propozojmë disa nga ndryshimet e mundshme:

1. Fjalëformimi është propozuar të mësohet pasi që është propozuar mësimi i funksionit të fjalëve. Fjalëformimi do të duhej të ishte në fillim.
2. Lidhshmëria e pjesëve të ligjëratave, si në sistemin emëror dhe në sistemin foljor duhet të planifikohet në mënyrë kronologjike.
3. Funksioni i fjalëve në fjali duhet të planifikohet pasi është ligjëruar dhe planifikuar për fonetikën, morfologjinë dhe leksikologjinë. Këtu kërkohet një përqendrim m’i kujdesshme.

Ky program është më mirë i strukturuar, mirëpo ka nevojë për ristrukturim dhe si i tillë duhet të mendohet për gjitha trojet shqiptare, por edhe për diasporën.

**d. Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim - Kurrikulat lëndore, programet mësimore. Gjuhë shqipe (**klasa e dhjetë**). Referuara përbërjes përmbajtjesore të programit në fjalë, këtu kemi një strukturim më të ngritur dhe si strukturë e tillë ka një mundësi reale për t’i përgatitur edhe tekstet në nivel të shkëlqyer. Në vazhdim e citoj një pasqyrim të programit:

<i>“Konceptet</i>	<i>Temat</i>	<i>Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)</i>
<i>Sistemi gjuhësor</i>	<p><i>“Gjuha standarde dhe gjuha e letërsisë,</i></p> <p><i>Mbiemri, ndajshtimi</i></p> <p><i>Pikësimi dhe efektet letrare,</i></p> <p><i>Format e sentencave, fjalive, funksioni.</i></p> <p><i>Pjesët e ligjëratës dhe fjalia (funksioni morfosintaksor)</i></p> <p><i>Fjalia dhe stili</i></p> <p><i>Procesi i shkrimit</i></p> <p><i>Eseja</i></p> <p><i>Ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes,</i></p> <p><i>Trajtat e pashtjelluara të foljes</i></p> <p><i>Gjuha te letërsia e vjetër dhe te krijimtaria gojore</i></p>	<p><i>Dallimi i shqipes standarde nga gjuha e letërsisë.</i></p> <p><i>Identifikimi i mbiemrit/ndajshimit dhe funksioneve të tij në tekste letrare dhe jo letrare.</i></p> <p><i>Përdor pikësimin/drejtskrimin për efekte letrare.</i></p> <p><i>Analizë e sentencave efektive dhe të kombinuara/ rishikimi i modeleve të sentencave bazike dhe hyrje në modelet e sentencave të reja.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Identifikimi i (i kohëpaskohshëm) i pjesëve të ligjëratës dhe funksioneve të tyre morfosintaksore.</i></li> <li>- <i>Analizon stilistikën e fjalive të kombinuara e sentencave efektive duke sprovuar modelin e ri të sentencës/paragrafit.</i></li> <li>- <i>Zhvillon strategjinë e shkrimit, si zgjerimi apo reduktimi i sentencës/paragrafit.</i></li> <li>- <i>Shkruan lloje të ndryshme të esesë (auto/biografike dhe hulumtuese).</i></li> <li>- <i>Kupton ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes, shembuj nga letërsia e vjetër.</i></li> </ul>

	<p><i>Gjuha standarde dhe gjuha e folur.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Praktikon trajtat e pashtjelluara të foljes.</i></li> <li>- <i>Dallon gjuhën standarde nga gjuha e teksteve të vjetra shqipe dhe nga gjuha e folur.</i></li> <li>- <i>Praktikon struktura të ndërliqshme gramatikore me shkrim e me gojë (Kurrikula lëndore, klasa e dhjetë)”.</i></li> </ul>
--	--	---

*Tabela 4*

Programi i klasës së dhjetë ka një planifikim më të zhvilluar e gjithëpërfshirës, pra ka një strukturë më të thelluar. Kurrikula e klasës së dhjetë ka një përfshirje të gjerë, e cila mund të jetë ngarkesë edhe për hartimin e teksteve, mirëpo po do të respektohet kujdesshëm përmbajtja e saj, teksti mund të krijohet në një nivel të pranueshëm, prandaj edhe ky program ka ndonjë mundësi reale për ta modifikuar, mirëpo është më gjithëpërfshirës dhe më i pranueshëm.

Kurrikulat në nivel të kombit duhet të jenë të standardizuara dhe të modifikuara për gjithë shoqërinë shqiptare, madje edhe për diasporën.

Kurrikulat duhet të rimendohen edhe për minoritetet që e kanë të obliguar apo plotësuese për ta mësuar gjuhën shqipe.

Për të përfunduar këtë pjesë të analizës mund të themi si mësimdhënësi i kualifikuar për të ligjëruar në shkollën e mesme të ulët është ai apo ajo, i cili apo e cila e ka të mbaruar gjuhën dhe letërsinë shqipe në Fakultetin e Filologjisë, por nuk është i kualifikuar ai apo ajo, i cili e ka të mbaruar programin e gjuhës shqipe, apo vetëm të letërsisë shqipe në Fakultetin e Filologjisë, sepse kurrikula është e integruar gjuhë dhe letërsi, por nuk është e ndarë.

#### **4. Gjuha shqipe dhe programet universitare**

Programet universitare, në nivel kombi, të cilët përgatisin mësimdhënës të gjuhës shqipe nuk janë të unifikuara dhe nuk janë të standardizuar dhe si të tilla kanë dallime përmbajtjesore, strukturore e shkencore në misionin dhe vizioni e tyre. Kjo dallueshmëri është si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri dhe në Maqedoni, prandaj në misionin dhe vizionin e tyre kërkohet që të unifikohen dhe të standardizohen programet e studimeve në mënyrë që të kualifikuarit të jenë të barabartë me njohurit e tyre, kudo që diplomojnë, si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë saj.

Programet e studimeve themelore dhe ato të masterit profesional për mësimdhënie e për shkencë kanë dallime tepër të dukshme përmbajtjesore ndërmjet programeve universitare që janë në Kosovë, Shqipëri dhe në Maqedoni, të cilat dallime nuk janë në favor të shoqërisë. Mësimdhënësi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, i cili ka diplomuar në Prishtinë, Prizren, Tiranë, Tetovë etj., nuk është i njëjti me njohuri studimore, por në fakt janë të kualifikuar për mësimdhënie të gjuhës shqipe.

Këto divergjenca, të cilat kanë zënë vendin gjithandej, kërkohen sa më parë të unifikohen dhe të standardizohen në gjithë kombin tonë.

Universitetet shtetërore, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri e në Maqedoni kanë dallime dhe ngjashmëri në programet e tyre, të cilat janë të akredituara për të përgatitur mësimdhënës të gjuhës shqipe, si në nivelin universitar, ashtu edhe në ato pasuniversitar.

Studimi ynë analizues, i cili është bërë duke i krahasuar emërtimet edhe lëndët që i përbëjnë programet e studimeve ka rezultuar se kanë dallime substanciale ndërmjet tyre, mirëpo në këtë përshkrim analizues nuk ka hapësirë profesionale për t'i përshkruar ngjashmëritë dhe dallueshmëritë ndërmjet programeve që janë të akredituara për të përgatitur mësimdhënës të gjuhës shqipe.

Në vazhdim e prezantoj një tabelë, e cila vetëm për një semestër mund të shihen dallimet objektive ndërmjet disa universiteteve, citoj:

<p align="center"><b>Universiteti i Prishtinës</b>  <b>Fakulteti i Filologjisë</b>  <b>Programi: Gjuhë shqipe</b>  <b>Semestri i parë</b></p>	<p align="center"><b>Universiteti i Tiranës</b>  <b>Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë</b>  <b>Programi: Baçelor gjuhë dhe letërsi</b>  <b>Semestri i parë</b></p>
<p>Norma e shqipes së shkruar  Gjuhë e huaj  Histori e letërsisë shqipe 1  Teori e letërsisë  Fonetikë dhe fonologji e gjuhës së sotme</p>	<p>Hyrje në gjuhësi  Hyrje në historinë e gjuhës shqipe  Histori e gjuhësisë  Njohiri për letërsinë dhe për zhanret letrare  Etnofolklor dhe antropologji kulturore  Histori e estetikës  Histori e gjuhës standarde  Histori shkrimi  Teksti dramatic</p>
<p align="center"><b>Universiteti i Prishtinës</b>  <b>Fakulteti i Filologjisë</b>  <b>Programi: Letërsi shqipe</b>  <b>Semestri i parë</b></p>	<p align="center"><b>Universiteti i Prizrenit</b>  <b>Fakulteti i Filologjisë</b>  <b>Programi: Gjuhë dhe letërsi shqipe</b>  <b>Semestri i parë</b></p>
<p>Hyrje në teorinë e letërsisë  Letërsi popullore 1  Letërsi e vjetër shqipe 1  Shqipja e shkruar<sup>3</sup>  Gjuhë e huaj</p>	<p>Hyrje në gjuhësi  Fonetikë e gjuhës shqipe me fonologji 1  Hyrje në shkencën e letërsisë  Letërsi popullore  Kulturë gjuhe 1  Gjuhë angleze 1  Kulturë dhe qytetrim shqiptar  Histori e popullit shqiptar (Z)  Histori e popullit shqiptar (Z)</p>

<sup>3</sup> Saktësia shkencore e prezantimit të tabelës në fjalë mund të verifikohet në referencat që janë dhënë në literaturë.

<p style="text-align: center;"><b>Universiteti i Gjakovës</b> <b>Fakulteti i Filologjisë</b> <b>Programi: Gjuhë dhe letërsi shqipe</b> <b>Semestri i parë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Universiteti i Tetovës</b> <b>Fakulteti i Filologjisë</b> <b>Programi: Gjuhë dhe letërsi shqipe</b> <b>Semestri i parë</b></p>
<p>Fonetikë dhe fonologji e shqipes Hyrje në gjuhësi Gjuhë e huaj Gjuhë latine Histori e letërsisë shqipe 1 Letërsi popullore</p>	<p>Fonetikë dhe fonologji 1 Teori e letërsisë 1 Letërsi për fëmijë 1 Letërsi e vjetër shqipe 1 Letërsi popullore 1 Gjuhë angleze 1 Drejtskrim i gjuhës shqipe 1 Fonetikë historike; Shkrim kreativ.</p>

*Tabela 5*

Duke ju referuar tabelës në fjalë mund të themi se programet e gjuhës dhe të letërsisë shqipe kanë dallime dhe si të tilla me një urgjencë kombëtare duhet t'i modifikojmë e t'i standardizojmë.

Në vazhdim i përshkruajmë vetëm emërtimet e programeve, të cila kanë dallime dhe ngjashmëri ndërmjet universiteteve tona:

1. Universiteti i Prishtinës, përkatësisht Fakulteti i Filologjisë i ka të ndara studimet themelore në degën: **Gjuhë shqipe dhe Letërsi shqipe**, po ashtu edhe për studimet e masterit.
2. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit e ka masterin: **Mësimdhënia në gjuhë dhe letërsi shqipe**.
3. Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Filologjisë i ka studimet themelore: Gjuhë dhe letërsi shqipe.
4. Universiteti i Gjakovës, Fakulteti i Filologjisë i ka studimet themelore: Gjuhë dhe letërsi shqipe, kurse për master ka: Master të shqipes dhe planifikim për studime letrare.
5. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë ka për studime themelore: Bachelor në gjuhë dhe letërsi; Master profesional

në redaktori; Master profesional në gjuhë dhe letërsi; Master profesional në gjuhësi e sotme; Master i shkencave në gjuhësi historike; Master shkencor në letërsi, po ashtu ka edhe programin e doktoratës.

6. Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore i ka studimet themelore: Baçelor në gjuhë-letërsi; Master i shkencave në *'Studime të thelluara të gjuhësisë'*; Master profesional mësuesi gjuhë-letërsi; Master shkencor në etnokultura dhe letërsia shqipe.
7. Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Shkencave Humane i ka studimet themelore: Baçelor në gjuhë shqipe dhe letërsi; Baçelor në gjuhësi të aplikuar në fushë të turizmit.
8. Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave Humane i ka studimet themelore: Baçelor në gjuhë shqipe dhe letërsi; Master në gjuhësi, kurse doktoratën: Albanologji, profili gjuhësi.
9. Universiteti i Durrësit, Fakulteti i Edukimit i ka studimet themelore: Gjuhë shqipe – letërsi; Master për gjuhën shqipe dhe letërsinë; Master për arsimin e mesëm të ulët për gjuhën shqipe-letërsi dhe gjuhë angleze.
10. Universiteti i Korçës, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, i ka studimet themelore: Baçelor në gjuhë dhe letërsi; Master profesional për mësues të gjuhës shqipe dhe letërsisë.
11. Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë i ka këto programe: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe – drejtimi arsimor për studimet themelore dhe për master i ka Master gjuhë shqipe dhe Master letërsi shqipe.

## **5. Rekomandime**

Mbështetur në atë që e kemi përshkruar dhe duke i kuptuar dallimet që janë ndërmjet kurrikulave dhe programeve studimore, konsideroj se janë të obliguara për t'i sistemuar e unifikuar këto çështje:

- Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia duhet që të formojnë komisione të përbashkëta për hartimin dhe fuzionimin e plan-programeve (kurrikulave) të gjuhës shqipe.
- Fjala '*kurrikulë*' nuk duhet të përdoret, por ajo mund të zëvendësohet me '*plan-program*'.
- Fjala '*bachelor, baçelor*' nuk duhet të përdoret, por duhet të zëvendësohet me grupin e fjalëve '*studime themelore*'.
- Duhet t'i rishikojnë plan-programet (kurrikulat) ekzistuese.
- Duhet t'i standardizojmë e unifikojmë plan-programet e gjuhës shqipe, por edhe të jenë funksionale për gjitha qendrat shqiptare.
- Plan-programet dhe tekstet parauniversitare duhet të jenë të njëjtat, në gjitha trojet shqiptare, kudo që mësohet gjuha shqipe.
- Duhet t'i modifikojmë e t'i standardizojmë plan-programet (kurrikulat) për diasporën.
- Duhet t'i modifikojmë kurrikulat për mësimin e gjuhës shqipe për minoritete.
- Në nivel të universiteteve, programet e studimeve themelore duhet t'i kemi të njëjtat dhe të unifikuara e të standardizuara për gjitha universitet që përgatisin mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe.
- Mësimdhënësit e kualifikuar për gjuhë dhe letërsi shqipe duhet të përgatiten vetëm në Fakultetet e Filologjisë.
- Masteri për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe duhet të përgatiten vetëm Fakultet e Filologjisë dhe nuk duhet të përgatiten fakultetet e ngjashme, siç është rasti i Fakultetit të Edukimit.
- Duhet të formohet një qendër e përbashkët ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë për ta shtrirë interesimin e vazhdueshëm dhe për ta mbajtur gjallë gjuhë shqipe në diasporë.

## **Përfundim**

Plan-programet (kurrikulat) janë të hartuar dhe janë të miratuara nga MASHT-i. Mbi bazën e tyre do të duhej t'i ndërtojnë tekstet. Autorët nëse i kanë respektuar kurrikulat, të cilët janë të obliguar për t'i respektuar, tekstet do të dalin si brumi i plan-programeve. Gjuha dhe rregullat e saj mund të mësohen edhe me një planifikim të tillë, por lidhshmëria e tyre i ka krijuar hapësirë për t'i risistemuar. Qëllimi i mësimit të gjuhës shqipe nga klasa e parë, e tretë, e gjashtë dhe e dhjetë, e cila është planifikuar të mësohet me tema të ndryshme, duke filluar për të mësuar nga tingujt e deri të funksioni i fjalëve në fjali, ashtu si e kemi prezantuar në këtë punim ka hapësirë për modifikim. Analizat dhe përshkrimet që janë dhënë për plan-programin e klasës së parë, të tretë, të gjashtë dhe të dhjetë janë përshkrime dhe rekomandime thelbësore për t'i rirregulluar dhe për të siguruar përputhshmëri profesionale ndërmjet kurrikulës, programeve universitare dhe teksteve cilësore.

Pjesa e rekomandimeve që është dhënë në këtë punim mund t'i shërben hartuesve të kurrikulave për t'i risistemuar dhe plotësuar me saktësi sistemin gramatikor.

Kurrikulat dhe tekstet gjuhësore për gjuhën shqipe, por edhe programet universitare do të duhej të jenë të njëjta si në Kosovë, Shqipëri dhe në Maqedoni, por edhe të standardizuara edhe për diasporën shqiptare e për minoritetet që jetojnë në këto vende.

## **Literatura**

1. Grup autoresh. (2002). *Gramatika e Gjuhës shqipe I*. Tiranë.
2. Grup autoresh. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë.
3. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*, Klasa e parë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018, f. 5. <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>
4. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*, Klasa e parë, botuar nga MASHT-i,

Prishtinë, 2018, f. 11.

5. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*, Klasa e tretë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018, f. 9.
6. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*, Klasa e gjashtë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018, f.11
7. Kurrikula lëndore – Programet mësimore, Klasa e dhjetë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018, f.16.
8. Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.
9. Korniza Kurrikulare e Arsimit Pariauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar), Prishtinë, 2016.
10. Kurrikula bërthamë arsimit të mesëm të ulët të Kosovës (Klasa VI, VII, VIII dhe IX, e rishikuar), Prishtinë, 2016.
11. Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V, e rishikuar), Prishtinë, 2016.
12. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*; Klasa e dhjetë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018.
13. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*; Klasa e gjashtë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018.
14. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*; Klasa e parë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018.
15. Kurrikula lëndore – *Programet mësimore*; Klasa e tretë, botuar nga MASHT-i, Prishtinë, 2018.
16. Millaku, Sh. (2011). *Strukturat sintaksore*. Prishtinë.
17. Millaku, Sh. (2011). *Studime gjuhësore I*. Prishtinë.
18. Millaku, Sh. (2015). *Kërkime gjuhësore*. Prizren.
19. Millaku, Sh. (2017). *Tekst ushtrimesh për lakimin e emrave dhe zgjedhimin e foljeve*, Prishtinë.
20. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë: [456ED100-EBDE-40B0-9E83-F20CADB1C239.pdf](https://www.ub.edu/456ED100-EBDE-40B0-9E83-F20CADB1C239.pdf)

21. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit: Universiteti i Prishtinës, Master i Mësimdhënies lëndore (me specializimet: Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi, Histori, Gjeografi, Teknologji dhe TIK)
22. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë: Syllabuset – GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE – UPZ
23. Universiteti i Gjakovës, Fakulteti i Filologjisë: Programi Gjuhë Shqipe dhe Letërsi | Universiteti i Gjakovës | Fakulteti i Filologjisë
24. Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave të Shoqërore
25. Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Shkencave Humane: UNIVLORA - Universiteti "Ismail Qemali" Vlore, Virtus Scientia Veritas
26. Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave Humane: Programet e studimit
27. Universiteti i Durrësit, Fakulteti i Edukimit: Departamenti i Gjuhës Shqipe - Universiteti "Aleksandër Moisiu"
28. Universiteti i Korçës, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë: DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
29. Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë: Fakulteti Filologjik – Universiteti i Tetovës